



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:005663
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06786218

C. nr.237/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi në çështjen juridike kontestimore të paditësit Zh. Gj. nga të cilin e përfaqëson me autorizim J. F. avokate nga Graqanica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson me autorizim Arbnor Murturi, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti lidhjen e kontratës së punës në kohë të pacaktuar si dhe kthimin në listën e pagave, jashtë seancës gjyqësore, më datën 27.01.2025 mori këtë:

AKTVENDIM

I. HEDHET POSHTË padia e paditësit Zh. Gj. nga, e parashtruar ndaj të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Kamenicë, përmes së cilës ka kërkuar nga gjykata, që të

VËRTETOHET se paditësit Zh.Gj. nga, në mënyrë të kundërligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës si profesor i mësimit klasorë-mësimdhënës në shkollën fillore "Desanka Maksimoviq", te punëdhënësi- e paditura Komuna e Kamenicës, të

OBLIGOHET e paditura Komuna e Kamenicës që në afat prej tetë ditësh nga data e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit ta kthej në vendin e punës paditësin Zh.Gj. dhe të caktojë në punë në përputhje me aftësimin profesional dhe aftësinë e punës, të

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Zh. Gj. nga ndërsa e paditura Komuna e Kamenicës **OBLIGOHET** që t'ia paguaj paditësit Zh. Gj. fitimet e humbura për shkak të ndërprerjes së kundërligjshme të kontratës së punës për

periudhën 30.08.2019 dhe deri në ditën e nxjerrjes së aktgjykimit, dhe çdo shumë mujore me kamatë ligjore të vonesës, duke llogaritur të njëjtën nga data e arritjes deri në pagesën përfundimtare, **SI E PASAFATSHME**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Zh.Gj. nga më datën 11.12.2019, në këtë Gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale për Arsim në Kamenicë, me objekt kontesti, lidhjen e kontratës së punës në kohë të pacaktuar si dhe kthimin në listën e pagave.

Në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në shpjegimet përfundimtare, paditësi përmes të autorizuarit të sajë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve dhe parashtrësive të dorëzuara në gjykatë, duke theksuar se kërkesëpadija e padisë është plotësisht e bazuar dhe propozon që gjykata të aprovoj të njëjtën në tërësi. Tutje ka theksuar se në këtë rast duhet të zbatohet Ligji për Shërbyesit Publikë 06/L114, në të cilin pala e paditur është thirr në seancën e mbajtur më datë 17.12.2024, pasi në Ligjin për Shërbyesit Publik 06/L-114, në asnjë fjali të vetme nuk përmendet se ky ligj rregullon statusin e punëtorëve në institucionet arsimore, duke shtuar se padia është dorëzuar në gjykatë në mënyrë të rregullt dhe në afatin e përcaktuar ligjor. Njëherit ka theksuar se pas shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të Fondit të Trustit, paditësit i janë derdhur fonde në të njëjtin fond që nga viti 2008 deri më 30.08.2019, me shënim se pagesat kanë filluar më herët, në vitin 2005. Paditësi Zh. D. ka pasur marrëdhënie pune për më shumë se 10 vite, konkretisht 14 vite dhe është e qartë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune që është shndërruar në marrëdhënie pune për kohë të pa caktuar. Paditësi ka dëshmuar se marrëdhëniet e tij e punës ka përfunduar në mënyrë të pa ligjshme pa ndonjë dokument të dorëzuar që mund të konsiderohet si njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ose ndonjë akt nga autoritetet kompetente. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, edhe atë në shumë të përgjithshme prej 1.257,00 euro.

I autorizuari i të paditurës, Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale Arsim në Kamenicë, përmes të autorizuarit të tij, në seancën përgatitore dhe gjatë shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që së pari të ketë parasysh afatin e paraqitjes së padisë kjo për arsye se e njëjta është e pa afatshme duke qenë se

padia është dorëzuar me dt.11.12.2019, ndërsa ankesat dhe kërkesa e fundit është dorëzuar me dt.28.10.2019, duke qenë se ligji i punës parasheh që padia mund të ngritët brenda afatit prej 30 ditësh dhe duke qenë se ky afat është tejkaluar konsiderojmë që padia e paditësit duhet të hedhet poshtë si e pasafatshme. Paditesi pretendon se i është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme marrëdhënia e punës me arsyetimin se kontrata e tij e punës duhet të konsiderohet si kontratë me kohë të pa caktuar në kuptim të nenit 10, par.5 të ligjit të punës, megjithatë paditësi nuk ka bashkangjitur prova të besueshme me anë të cilave vërtetohet se i është përtërirë Kontrata e Punës pranë të paditurës në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 vite, lidhur me këtë paditësi pretendon se e ka vërtetuar këtë fakt me anë të pasqyrës së TRUST-it për periudhën 01.08.2002 deri më 27.03.2024, mirëpo me anë të këtij dokumenti nuk pasqyrohen të dhëna lidhur me punëdhënësin, vendin e punës dhe detaje të tjera lidhur me marrëdhënien e punës. Nga provat e administruara nga gjykata, dëgjimi i dëshmitarit dhe dëgjimi i paditësit në cilësi të dëshmitarit, e paditura konsideron se kërkesëpadia e paditësit shihet qartë se është e pabazuar, dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë provë materiale me të cilën provohet pretendimi i tij, dhe ka kërkuar nga gjykata qe komfor neneve 143, 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të merr aktgjykim ku refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Zh. G. dhe të detyrohet i njëjti që të paditurës të ja paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 540.08 euro.

Gjykata, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për rregullësin e padisë sa i përket afatit për paraqitjen e padisë në gjykatë, gjeti se padia e paditësit Zh. Gj., është parashtruar jashtë afatit ligjor, të paraparë me dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, pasi që paditësi, sipas pretendimit të tij në padi, fillimisht me kërkesën e datës 26.08.2019 i ishte drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit – Mirhane Besimi Morina, nga e cila kishte kërkuar informata se me cilat kriterë ligjore apo ndonjë rregullore, drejtorët (e shkollave fillore) bëjnë vazhdimin dhe ripërtëritjen e Kontratës për punëtorët të cilët tashmë punojnë një kohë të gjatë, e më pastaj përsëri me kërkesë me datë 28.10.2019 i ishte drejtuar me Kërkesë përsëri Drejtorisë Komunale të Arsimit – Znj. Mirhane Besimi Morina, duke insistuar që ti përgjigjet dhe duke theksuar se nuk ka marr përgjigje në kërkesën e datës 26.08.2019 e duke insistuar që e njëjta ti përgjigjet. Nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe kontratat paraprake të bashkangjitura padisë nga paditës, i njëjti çdo fillim vit kishte nënshkruar kontratë të punës me 01 shtator, përkatësisht 2 apo 3 shtator kur edhe kishte filluar viti shkollor, varësisht se në cilën datë ka qenë dita e parë e punës në muajin Shtator, dhe e njëjta kontratë ka zgjatur deri me datën 30 apo 31 Gusht të vitit vijues, pra mësimdhënësit, në këtë rast edhe paditësi, për ç’do vit kalendarik kanë

lidhur kontratë pune me vlefshmëri nga muaji Shtator i vitit përkatës, deri në fund të muajit gusht të vitit tjetër kalendarik, me çka nënkuptohet se me datë 28.10.2019 kur paditësi i ishte drejtuar me Kërkesë Drejtorisë Komunale të arsimit, vetëm se ishte njoftuar se për vitin kalendarik nuk është i angazhuar, *(meqenëse në fillim të muajit shtator, si çdo vit tjetër i njëjti nuk është ftuar për të nënshkruar kontratës e punës për vitin kalendarik 2019/2020)*, pra në rastin konkret paditësi me datën 02 shtator kishte qenë i njoftuar se e paditura nuk ka ndërmend që me të njëjtin të lidhë kontratë pune me afat të caktuar sikurse vitet paraprake, ndërsa tek me datë 28.10.2019 i ishte drejtuar të paditurës me kërkesë, pra 57 ditë pasi që e kishte kuptuar se për vitin 2019/2020 nuk është ftuar të angazhohet, ndërsa padinë në gjykatë e kishte dorëzuar rreth 71 ditë pasi që i njëjti nuk ishte ftuar për të nënshkruar kontratën e punës për vitin 2019/2020 kur edhe ka filluar të rrjedhë afati për mbrojtjen e tij nga marrëdhënia e punës komfor nenit 79 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212. Prandaj duke e pasur parasysh kohën e kaluar nga kjo datë e deri me datën e paraqitjes së padisë në gjykatë me datën 11.12.2024, kanë kaluar mbi 2 muaj, rrjedhimisht paditësi e ka humbur afatin ligjor të paraparë me nenin 79 të Ligjit të punës të sipërcituar, brenda të cilit ka mundur të kërkojë mbrojtje ligjore nga gjykata përmes padisë së paraqitur në gjykatë, lidhur me kërkesën e paraqitur përmes padisë.

Gjykata deri te ky konstatim erdhi duke u bazuar në shkresat e lëndës, sipas të cilave rezultoi se paditësi fillimisht si palë e pakënaqur me vendimet e organeve administrative përkatëse të cekura si më lartë, ka vazhduar në procedurën administrative dhe ka paraqitur ankesë duke e kontestuar të njëjtin si të pabazuara. Mirëpo paditësi nuk është kujdesur për nxënien e afatit ligjor – prekluziv të paraparë me nenin 79 Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, për paraqitjen e padisë në gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, pasi që e ka pranuar vendimin e punëdhënësit apo mos përgjigjes nga punëdhënësi brenda afatit prej 15 ditëve.

Me dispozitat e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, përkatësisht me dispozitën e nenit 78 të këtij ligji parashihet se *“I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”*. Pastaj me dispozitën e nenit 79 të po këtij ligji parashihet se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin*

vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”. Ndërsa me dispozitën e nenit 391 pika (f) e LPK-së parashihet se “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”, në rastin konkret afati për paraqitjen e padisë ka qenë i përcaktuar me dispozita materiale, konkretisht me nenin 79 të Ligjit të Punës.

Gjykata vlerëson se paditësi ka pasur të drejtë ligjore që në mënyrë të lirshme të ushtrojë mjetet juridike në rrugë gjyqësore, mirëpo përdorimi i këtyre mjeteve juridike është dashur të bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat e neneve 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Andaj, mos shfrytëzimi i këtyre mjeteve juridike brenda afateve të caktuara (afate prekluzive), ka si pasojë edhe humbjen e të drejtës për mbrojtje gjyqësore, dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar paditësit, por për shkak se ky i fundit ka dështuar që me kohë t’i shfrytëzoj këto mjete juridike të cilat i ka pasur në dispozicion. Paditësi në rastin konkret ka humbur te drejtën në mbrojtje gjyqësore pasi që padinë e ka parashtruar jashtë afatit ligjor nga shkaqet e lartcekura. Gjykata sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta në bazë të dispozitës se nenit 450 dhe 463.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 391 pika f) të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendim.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil

C. nr. 237/19, më datë 27.01.2025

G j y q t a r i

Valbonë Dërvodeli, d.v.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:005663
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06786218